


PROCESVERBAL I/2025



I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2025 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.01.2025
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Nenkryetratja e Komunes, Mihrije Suka
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6358, të datës 28.01.2022 ;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës ;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit me numër të protokollit 01-Nr-052-2910 të datës 14.01.2025 dhe Marrëveshjes;**
7. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;**

Kryesuesi- Përshëndet të pranishmit dhe i njofton për një pikë shtesë që është bartja e te hyrave vetanake të vitit 2024 për shpenzime për vitin 2025. Unë kerkoj që ta fusim si pikë shtesë sepse kto janë grumbulluar nga te hyrat vetanake ne fund të vitit të cilat nuk kan mund me u shpenzua.

Liridon Fandaj – Përshëndet të pranishmit. Unë kërkoj me fut edhe një pikë shtesë, pasi që ky komision është komisioni kryesor për Politikë dhe Financa, pjesa tjetër, përveq tejkalimit të hyrave por kemi një pjesë tjetër, hapësirat publike po shfrytëzohen nga operatorët ekonomik që nuk kanë kontrat, ato të hyra duhet mu kanë shqetësuese edhe për këtë komision që dikush tjetër i inkason e nuk ka as kontratë as marrëveshje me Komunën. Nëse Komuna nuk ka mujt prej vitit 2022 me ja dhënë një operatori ekonomik kjo është shqetësuese ose u deshtë Komuna me i marrë ato të hyra me e angazhua vetë një njeri. Janë dy pozicione, pjesa e reklamave dhe në zonë industriale deponia. Te deponia është dashtë Drejtori me na dhanë një arsyetim.

Kryesuesi- Sa i përket deponisë është në rend dite.

Liridon Fandaj- është pak shqetësuese se kush është duke inkasuar këto të hyra. Nëse sot na e kemi si pikë shtesë tejkalimin duhet të ishin dhe ato të hyra këtu që ne më mirë me i ba projekte kapitale tjera sesa një operatori ekonomik për një muaj me i përfitu 60.000€ veç prej reklamave të fushatës. Kërkoj nga ju që ta fusim si pikë shtesë.

Kryesuesi- e hedh në votim pikën 1 shtesë

4 Për, 2 Abstenime , Miratohet

Kryesuesi - E hedh në votim pikën e 2 shtesë sa i përket reklamave.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.; Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6358, të datës 28.01.2022 ;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha – Ne si komision paraprakisht,a është dashtë me ditë si emër kush do të vjen?

Avni Bytyqi- Sa kam informacione është Halime Gashi.

Bulëza Kuqi-Përshëndet të pranishmit. Mua po më duket pak si i vonum prej DKA-së,për derisa e din rastin,kohen,datën se kur ka me dal në pension sepse konkursi për bursa veq është hap,aplikimet kanë filluar,brenda dy jave veq fillon me u mbajtë komisioni. Është dashtë pak më heret sepse data e pensionimit nuk i ndryshon.

Urim Suka- përshëndet të pranishmit,unë deshtë me ju bashkëngjitë shqetësimit të Dardanit ,DKA është dasht me naj pru së pari një propozim që na me e ditë edhe për emrin konkret edhe me vazhdu si procedurë me votu me kalu,sepse eshte çeshtje teknike që duhet me shku,ne si LDK e mbështesim si propozim.

Avni Bytyqi-përshendet të pranishmit,rregullorja për ndarjen e burave për nxënës dhe student e specifikon shumë kuart që tre vin nga kuvendi dhe dy prej ekzekutivit të Komunës, ekzkluzivisht kjo është e drejtë e DKA-së se kë e propozon,por ju keni të drejtë të mos e votoni,mirpo megjithatë është procedurë që duhet të vazhdohet dhe mendoj që nuk duhet të diskutohet për këtë temë për arsye se aty për aty DKA mund të jep propozimin. Nuk është hera e parë që vin komisionet për plotësim-ndryshim të anëtarëve të komisionit asnjëherë nuk e kemi pru prej fillimit me emër , ne e kemi dhënë mundësinë që emrat të jepen në mbledhje të Kuvendit,edhe aty besoj që Drejtori i Arsimit ka me e dhënë emrin,propozimin që kush ka me qenë.Unë e thash dhe më heret që kam informacione që ka me qenë Halimja si Zyrtare e Personelit do te jetë dhe anëtare eKomisionit që besoj do ti plotësoj të gjitha kushtet dhe kriteret për arsye që është në listë dhe ju ndihmon Komisionit me hartimin e raportit.

Urim Suka- Këto informacione kemi pas qef me i pas edhe na,dhe kur të votojna me dit për qka votojna përndryshe ne e mbështesim sepse është qështje teknike që ky Komision duhet mu plotësu për me i kry procedurat që nuk duhet me u vonu.

Kryesuesi- e hedh në votim pikën e 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtëshme të Komunës;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Kryesuesi - pasi që nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4; Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtëshme të Komunës;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj- Përshendet të pranishmit.Normalisht interesi i Komunës është me u dhënë pronat në shfrytëzim,e sidomos ato zona të cilat kanë nevojë me u fuqizu përmes funksionalizimit të asaj zone ne e dimë që është pak më pak e shfrytëzume se sa në krahasim nashta me zonën industriale në Shirokë mirpo shqetësimi jem është që ku po bazohet në plan rregullativ urban në zonën industriale dhe ne si kuvend me i shfuqizu të gjitha planet rregulluese ,me fuqizimin e hartes zonale Ministria pak a shumë ka kerku prej neve që me i shfuqizu planet rregulluese edhe ne me vendim të kuvendit i kemi shfuqizu planet rregulluese në bazë të miratimit të hartes zonale ,dmth aktualisht jemi pa plane rregulluese në këto Zona,andaj për pjesen te neni 1 pika 2 ku thuhet me destinimin sipas planit rregullativ urban të zonës Agrozona industriale në Samadrexhë unë propozoj që me shënu me destinim sipas hartës Zonale të Komunës qysh e ka destinimin,ndoshta është Agrozon dhe këtë kultivimi i perimeve në Sera mundet vetë Drejtoria me propozu se një zonë që është tokë bujqësore ,vet drejtoria mundet me propozu një destinim bujqësor se pse po do me e dhënë atë në shfrytëzim por që mos me përmend planin rregullativ Agrozona industriale për shkak që ne e kemi shfuqizu.Ndoshta edhe Avniu mundet me na ndihmu në këtë aspekt përshkak që ne e kemi marrë një vendim për shfuqizimin e planit rregullativ pas miratimit të hartës zonale.

Avni Bytyqi-unë pajtohem me atë se çfarë po e thu ti. Është e vërtetë që hartat zonale i kana shfuqizuar planet rregulluese mirpo kërkesa e drejtorisë të planifikimit të pronës ka ardhë sipas planit rregullues dhe ne ju kemi referuar kërkesës se tij. Ai u deshtë paraprakisht me e marr pëlqimin dhe me e marrë konfirmimin prej Drejtorisë së Urbanizmit se çka është e parapamë ajo sipërfaqe me destinim sipas hartës zonale dhe tek atëherë ne me inkorporua në kuadër fillimin,mirëpo megjithatë propozimi ynë nëse kalon këtu,unë projekte-vendimin e ndryshojë dhe e dërgoj me destinim sipas Hartës Zonale.

Sanije Kuçi Rexhepaj-Është mirë me u konfirmu nga drejtoria e urbanizimit se çka është e planifikime ajo zonë,është për bujqësi unë jam shumë e sigurtë sepse ne i kemi inkuadru të gjitha planet rregulluese që i kemi pasë në Hartë Zonale në plan zhvillimor komunal por që mirë është me u shënu emri i saktë se qysh është i shenum në Hartën Zonale .

Kryesuesi-e hedh në votim pikën 4.

6 Për,1 Abstenim,miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të Komunës ;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka- këtë temë e kemi diskutu edhe më heret por puna është shumë e çuditëshme kur kontrata ka skadu që një kohë shumë të gjatë.

Kryesuesi- Në muajin e shtatë.

Urim Suka-Si ekzekutiv jeni vonu.Na e dimë që për mos me lanë zbrazëtira të tilla 3-4 muaj përpara se me i kalu afati i një kontrate është mirë me u nisë procedura tjera,që kur të vje koha me u mbaru ajo kontrat veq me u kanë kontrata e re,por përtej kësaj,në këtë vend ku jan caktu këto mbeturina,ka pasë shpesh herë disa reagime nga njerëzit atje,që është e papershtatëshme ky vend atje,dhe ne kemi diskutu më heret dhe u fol atëherë që si të mbaron kontrata kena me e ndreq dhe kena me e dergu tjetër kun edhe tash po na vini me propozimin që përsëri në të njëjtin vend.Për derisa mua drejtëpërdrejtë disa njerëz atje mu kan anku për këtë pjesë që nuk është mirë me pas mbeturina atje,unë nuk muj me mbështet,kisha pas qef por tash nuk e kem por unë nuk e di si ekzekutiv a mundet dikush me na tregu që në aspektin procedural a ka edhe në bazë të këtyre hartave zonale ,planit zhvillimor a ka naj hapsir tjetër në Komunë që kishim mujt me ba zgjidhje tjetër që mos me vazhdu me qeto mbeturina te qekjo zone ku është atje por me gjet një hapsirë tjetër dhe me e ba një propozim tjetër .

Kryesuesi-Unë e kam një mendim që ata e kanë hulumtu rastin mirpo nuk kan mujt me gjetë parcel tjetër dhe prap jemi bazu tek ajo parcela se ka sipërfaqe të mjaftueshme aty edhe për disa vite për me hudhë mbeturina të ngurta.Sikur të kish pas e kishin bërë.Unë pajtona që po thu me shqetësim por është edhe lokacioni i mbeturinave në Landovicë, edhe Landovica nuk kanë qef me pas aty,por e kan caktu aty dhe krejt regjioni i Prizrenit i dergojnë aty sepse në cilin do vend që e qojmë atë,kanë me u anku.Ma mire të kemi një lokacion aty sesa me pas shumë të tjera.

Liridon Fandaj-Edhe unë i kam shqetësimet e njëjta me Urimin dhe e thash në fillim që duhet dikush ta menaxhon.Na e kemi themelu një kompani lokale ,po mendojë që kjo kompani kish mujt me e menaxhu qeta që ne mos me ja dhënë një operatori privat dhe qato të hyra që i marrim qaty me ardh në kompanin lokale ktu dhe me perfitu ajo kompani mosi e ka Bordin dhe i ka krejt.Është e formume dhe tash ish kan më mire me hy në kuader të asaj kompanie sesa me ja dhënë një operatori ekonomik.Nëse ajo si hapësirë në kuader të kohës sa jepet në shfrytëzim nuk i plotëson kushtet ,me kqyr një lokalitet tjetër me i qu por jo me i lan qaty e me ba kaos sepse ka shumë shqetësime të qytetaarëve aty dhe destinimi bëhet për mbetje të ngurta,nuk do të duhet te hedhin diqka tjetër.Ne krejt po e dim këtë punë por dyqysh po e lëm në heshtje,s'po e marrim si shqetësime që nesër mbasneser mundet me ndodh naj epidemi.

Kryesuesi-Realisht ajo është për mbeturina të ngurta,por qytetarët brenda tyre po fusin diqka tjetër.

Liridon Fandaj-është përgjegjësi e operatorit sepse ai e ka marrë për qata,por duhet inspekcioni me reagu,jo me lan qashtu qysh po ndodhë.

Kryesuesi- e hedh në votim pikën 5.

4 Për, 3 Kundër,Miratohet pika e 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit me numër të protokolit 01-Nr-052-2910 të datës 14.01.2025 dhe Marrëveshjes;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj- e lexova raportin,pika e 5 nuk e kam të qartë dhe meqenëse se Dardani ka qenë pjesë e komisionit,mundet me na dhanë një sqarim sa i përket ofertës së investitorit,komisioni ka formuluar vetem pikën ku ofrohen depo dhe garazha e që komisioni i ka kërkuar investitorit që komplet m2 prej 412.25 m2 të përfshihen në afarizëm dhe banim ashtu siç përcaktohen me kontratën,këtë spo e kuptoj.çka ka ndryshu komisioni dhe pse?

Dardan Berisha-Në bazë të marrëveshjes komisioni, ka pas me garazha dhe të gjitha këto,ne si komision marrveshjen e parë kur e ka dorezu operatori,ne s'e kemi pranuar vetëm këtë pikë që po e thua ti.Kemi kërku që me definu edhe një herë në takimin që ka qenë dhe me definu. Unë nuk kam qenë në takim,ata e kanë shtu e kanë zgjat,dmth ne nuk kemi hup si Komun kurgjo vetëm ka përfitu Komuna në këtë rast .

Sanie Kuçi Rexhepaj-Çka konkretisht?sepse nuk jam duke kuptu.

Kryesuesi-Nuk ka pranuar me marrë garazha e parkingje por lokale dhe banesa.

Dardan Berisha-Në ato m² në vend të depove parkingjeve ,sipas informacioneve që kam marrë nga Kryesuesja e komisionit ,ato m² i kanë shëndrru në banim.

Sanie Kuçi Rexhepaj-A ka pas të drejtë komisioni me e ba këtë shëndrrim të m² të depove dhe garazhas në njësi banesore dhe lokale afariste?

Kryesuesi-Besoj që po,pjesë e këshillit të urbanizmit ka qenë edhe kjo .

Sanije Kuçi Rexhepaj - por a është me të drejtë pune sepse edhe un kam qenë pjesë e një komisionit paraprak që e kemi bërë ndarjen e njësisve banesore për një çështje komplet tjetër,vend tjetër ,por që gjithmonë problematiken e kemi pas se a kemi të drejtë apo jo për me e bërë shëndrrim të m² nga diçka në diçka tjetër.

Dardan Berisha-Është dashtë me qenë edhe kryesuesja e komisionit,duhet me qenë shumë real,unë kam qenë pjesë e komisionit por asnjëherë s'kam qëndru deri në fund në takime.

Avni Bytyqi-Unë nuk jam pjesë e komisionit dhe nuk përzihem në atë pjesë por unë do të ju tregoj në aspektin ligjor që bazën ligjore nga ku e ka marrë komisioni që e ka bërë këtë ndarje teknike të banesave ,komisioni realisht ka punuar mbi bazën e 4 dokumenteve që janë dokumente ligjore që Komuna paraprakisht i ka aprovuar dhe i ka dhënë dritën e gjelbër komisionit për të vepruar. Dokumenti i parë ka qenë konkurrimi i hapur dhe vendimi paraprak që e kemi marrë, dhe ashtu është kanë konkurrim i hapur që në kuadër të konkurrimit të hapur komisioni për zhvillimin e procedurave e ka parapa që Komuna do të kompensohet vetëm me banesa dhe lokale afariste. E përmend saktë konkurrimi i hapur banesa dhe lokale afariste që në bazë të saj është dhënë dhe raporti i komisionit që i njëjti raport është miratuar me vendim të Kuvendit dhe i njëjti vendim vjen me konfirmimin nga MAPL që e përmend që Komuna do të kompensohet vetëm me banesa dhe lokale afariste prej 27% të objektit Neto, nga aty ka pësua edhe kontrata ka dal si derivat i vendimit dhe raportit të komisionit,kontrata që është nënshkruar mes Kryetarit të Komunës dhe operatorit përfitues, në kuadër të kontratës përmend dhe kjo çështje që Komuna do të kompensohet 27% me banesa dhe lokale afariste,do të thotë që kjo është baza në të cilën komisioni është bazuar dhe e ka bërë ndarjen dhe definimin e banesave sa i përket Komunës. Kjo pjesa a ka pas të drejtë apo jo,me vetë faktin që në kuadër të këtyre 4 dokumenteve ka qenë që Komuna do të kompensohet vetëm me banesa dhe lokale afariste atëherë komisioni ka pas të drejtë që të bëjë një gjë të till.

Sanie Kuçi Rexhepaj-Në këtë rast rrjedhimisht po i bjen që nuk kanë pas të drejtë me u marrë m² nga depo dhe garazhda. Dmth më shumë se 27% ka marrë Komuna.

Liridon Fandaj-Tek pjesa Neto e banimit,pjesa e sipërfaqes së objektit Neto 27%, nëse Komisioni ka vendos mos me i marrë ato,e ka rritë pjesen e %.

Avni Bytyqi - % nuk rritet.

Liridon Fandaj - nese në kontratë i thu investitorit ,në pjesen e objektit 27% ajo e përfshin edhe pjesen poshtë sepse m² i ka dhe poshtë.Nëse e keni bërë ndarjen kështu Komuna nuk ka përfitu.

Sanie Kuçi Rexhepaj - m² i depos dhe garazhdes që i ka propozu në fillim investitori në oferten e vet,a i keni shëndrru në banim?

Fidajje Kukaj-Po.

Dardan Berisha-Në thirrje publike.nuk ka qenë parkingje dhe garazhda.Në pikën e parë ne si komision e kemi refuzu ,kemi kërku diçka tjetër dhe ai kur ka ardhë i ka ofru qato metra për me i rritë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Mua po më shqetëson tek puna e raportit është se nuk po përmendet kerkun sipërfaqja e përgjithshme e objektit dhe sipërfaqja e përgjithshme Neto e objektit. Te ky raport po me doket e mangët kjo pjesë,se vetë po përmendet sa sipërfaqe po përfiton Komuna. Për shkak se te pjesa e vendimit që është i përpilua nga juristi përmendet që nëse në të ardhmen në atë objekt:shtohet,ose ka mbi ndërtim ose aneks në ndërtim prap se prapë Komuna është 27% përfituese e asaj. Ne mirë është me e pas këtë raport sa m² i ka aktualisht objekti dhe sa po i përfitojmë,që në të ardhmen me pas në raport të shënime.

Urim Suka - nuk jam 100% i përgaditun për lëndën në fjalë por ajo që po du me thënë është që ne si LDK duhet me pas vërejtje qysh prej fillimit tu ja nisë këto procedura dhe i kemi dhënë vërejtje që kjo

procedurë nuk është diçka në rregull.Këtu hala nuk është dhënë leje,atje janë hapë podrumet. Përtej asaj kjo marrëveshje që ka ardhë, kjo ndarje është pak e paqartë.

Kryesuesi-e hedh në votim pikën 6.

4 Për,3Kundër,Miratohet pika e 6

Pika 7.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin

Kryesuesi -pasi që nuk ka debat e hedh në votim.

4 Për,3 Kundër,2 Abstenimet miratohet pika e 7.

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024 të bartën për shpenzim në vitin fiskal 2025:

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj-Te ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skenderbeu,si projekt ai është në përfundim dhe pagesat në bazë të informatave jo zyrtare janë përfunduar,pse këto bartje në këtë kohë?

Fadil Hoxha- ZKF përshëndet të pranishmit. Si pasojë e vendimit të Gjykatave që janë ekzekutu deri në 30 kolektor mesin e këtij projekti është shuma që është ekzekutuar edhe ky projekt. Kështu që ne kemi pas mjete të mjaftueshme që juve ju kujtohet,në vitin e kaluar që i kemi bajtë 355,000€ bashkë me këtë projekt,dy herë i kemi qitë,dy herë na i kanë marrë,kështu që ne i kemi mbete borxh në bazë të dokumentacionit që e kemi. Realisht në buxhet kemi pas mjaftueshëm se vjet i kemi qitë diku në Mars në mbledhjen e muajit Shkurt kur është mbajtë dhe në Mars është bërë alokimi i tyre.

Kryesuesi-e hedh në votim pikën 8.

4 Për,3 kundër,miratohet pika 8

Pika 9.Diskutim për shfrytëzimin e hapësirave publike në Qytetin e Suharekës për vendosjen e panove reklamuese:

Kryesuesi - kjo pikë u vendos që të diskutohet në Asamble.

Takimi përfundoi: 14:00

Procesmbajtësja: Shyqerije Kuqi